



Departamenti i Prokurimit

Prishtine : datë,27.10.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.10.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “EJONA”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i ashensorit në objektin e vjetër të komunës”, me Nr. të Prok: 616 20 082 521 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të “EJONA” të dt. 26.10.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit “ Ndërtimi i ashensorit në objektin e vjetër të komunës”, me 616 20 082 521 kundër Njoftimit mbi vendimin e AK –së, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së .
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m


Operatori Ekonomik “EJONA” me datë 26.10.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i ashensorit në objektin e vjetër të komunës” me Nr. të Prok: Nr 616 20 082 521 . Autoriteti Kontraktues, me datë 01.07.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e Oe “Ejona jane te pabazuara, pasi qe per te gjitha kontratat, ka dorezuar certifikatat e kontrollit perfundimtar per furnizim dhe montim te liftave nga Minsitria e tregtise dhe industrise.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

A handwritten signature in black ink, appearing to be a stylized name, possibly 'A. ...', written over a horizontal line.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit